URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 227, datë 28.4.2022

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2022–2023 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2022–2023 të jetë, si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

a) Mësimet fillojnë më 12 shtator 2022 dhe mbarojnë më 14 qershor 2023.

b) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2022 dhe mbarojnë më 4 janar 2023.

c) Pushimet fillojnë më 3 prill 2023 dhe mbarojnë më 9 prill 2023.

ç) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 15–30 qershor 2023.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

a) Mësimet fillojnë më 12 shtator 2022 dhe mbarojnë më 14 qershor 2023.

b) Për maturat, mësimet fillojnë më 12 shtator 2022 dhe mbarojnë më 31 maj 2023.

c) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2022 dhe mbarojnë më 4 janar 2023.

ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 1–30 qershor 2023.

3. Në arsimin profesional:

a) Mësimet fillojnë më 12 shtator 2022.

b) Nxënësit e klasave të 10-ta, për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta, për strukturën 2+2, si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare mbarojnë mësimet më 14 qershor 2023.

c) Nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 2+1+1, dhe nxënësit e klasave të 11-ta, për strukturën 2+2, mbarojnë mësimet më 31 maj 2023.

ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor mbaron më 19 maj 2023.

d) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2022 dhe mbarojnë më 4 janar 2023.

dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të nivelit II dhe III të KSHK-së zhvillohen në periudhën 1–15 qershor 2023.

e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të nivelit IV të KSHK-së zhvillohen në periudhën 25–31 maj 2023.

ë) Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 1–30 qershor 2023.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj